



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- **Aktivitetet e përgjithshme**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- * **Trajnimi për trajnues**

Shtator 2022

Aktivitetet e përgjithshme

Program Shkëmbimi në Riga-Letoni EJTN WB II



EJTN pas shpalljes së vazhdimit të projektit për Ballkanin Perëndimor II, projekt trevjeçar i financuar nga Komisioni Evropian - Drejtori i Përgjithshëm për Zgjerim dhe Negociatat e Fqinjësisë (DG Near), ka njoftuar Akademinë e Drejtësisë së Kosovës e cila pastaj i ka bërë ftesë të gjithë përfituesve për aplikim.

Projekti synon të mbështesë dhe financojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Akademia e Drejtësisë e Kosovës dhe shkollat e tjera të trajnimit gjyqësor të Ballkanit Perëndimor në ngjarjet EJTN, duke përfshirë seminare dhe programe shkëmbimi.

Në kuadër të programit të shkëmbimit të mbajtur prej 29.08.2022 deri me 02.09.2022, të organizuar përmes EJTN në Riga-Letoni pjesëmarrës ishte gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe trajnuesi gjyqësor z. Ramush Bardiqi.

Kjo nismë u cilësua si mundësi e mirë për të shkëmbyer përvoja si me shtetin mikpritës gjithashtu edhe nga pjesëmarrësit tjerë. Në ditën e parë gjyqtari nga Kosova është takuar me znj. Solvita Kalniņa-Caune, Drejtoreshë LJTC dhe znj. Madara Blūmere, zyrtare e Programit të cilat kanë shpjeguar organizimin e trajnimeve nga kjo qendër si dhe me funksionimin dhe

rolin e Akademisë së Drejtësisë së Letonisë. Sipas agjendës në ditën e dytë është realizuar vizita në Gjykatën Rajonale në Rigë, ku z. Bardiqi është pritur në takim nga Kryetarja e kësaj Gjykate e cila ka ofruar informacion lidhur me strukturën dhe funksionimin e kësaj gjykate, si dhe pastaj ka marrë pjesë në një seancë në këtë Gjykatë.

Në ditën e tretë është vizituar Gjykata Supreme në Letoni ku janë takuar me udhëheqjen e administratës së kësaj gjykate dhe përmes videokonferencës me kryesuesen e komisionit për vlerësim të performancës së gjyqtarëve, Udhëheqësen e Departamenti Administrativ në Gjykatën Supreme. Në ditën e katërt, është bërë vizitë në prokurorinë, ku janë pritur nga shefja e administratës së prokurorisë në Riga. Në ditën e fundit është mbajtur një takim në Akademinë e Drejtësisë së Letonisë me znj. Solvita Kalniņa-Caune.

Në vijim citojmë z. Bardiqi për përshtypjet e tij lidhur me pjesëmarrjen në këtë program shkëmbimi: “Nga këndvështrimi im këtë program shkëmbimi e vlerësoj shumë lartë, si nga organizimi nga shteti mikpritës - Letoni, po ashtu dhe aktivitetet që kemi realizuar. Për mua ishte shumë e dobishme pasi që jam njoftuar më shumë lidhur me sistemin juridik të këtij shteti, strukturën organizative, sistemin e mbajtjes së trajnimeve, procesin e rekrutimit dhe vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mënyrën e organizimit dhe mbajtjes së seancave. Gjithashtu kemi mësuar shumë edhe lidhur me sistemin e drejtësisë së pjesëmarrësve tjerë që ishim në këtë program shkëmbimi”.

Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Më 05 dhe 12 shtator 2022, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë i



udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit z. Vaton Durguti, Udhëheqës i Departamentit Special në Gjykatën e Apelit.

Qëllimi i takimit për datën 05 shtator ishte diskutimi rreth draft koncept dokumentit të Ministrisë së Drejtësisë për Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, si dhe diskutimi i Projektligjit për Zyrtarët Publik. Më pas Këshilli Drejtues sipas agjendës vazhdoi me procedurën e shqyrtimit të Raportit të Komisionit për Vlerësimin e performancës së Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, të cilin e miratoi njëzëri.

Në fund të takimit u diskutuan edhe çështje të tjera të rëndësishme në kuadër të fushëveprimit dhe mandatit të Akademisë.

Më 12 shtator 2022, Sipas agjendës së përcaktuar për këtë takim, ishte prezantimi i vizionit të z. Enver Fejzullahu, Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë për zhvillimin dhe fuqizimin e Akademisë së Drejtësisë për periudhën e ardhshme 3 vjeçare. Gjatë këtij takimi u konfirmua se pavarësisht vështirësive dhe sfidave nëpër të cilat ka kaluar gjatë kësaj periudhe, janë arritur rezultate të larta në punë. Po ashtu, u zotua se edhe në vitet e ardhshme do të vazhdojë punën me profesionalizëm e korrektësi dhe me seriozitet do të kryej të gjitha punët dhe përgjegjësitë pranë AD-së.

Pas prezantimit të detajuar dhe diskutimit të hapur nga anëtarët e KD-së, unanimisht është votuar pro vazhdimit të mandatit tre (3) vjeçar të Drejtorit Ekzekutiv të AD-së, Enver Fejzullahu.



Trajnim në ERA në temën: “Aplikimi i të Drejtës së BE-së kundër diskriminimit

Me 22-23 Shtator 2022, nën organizimin e Rrjetit Evropian për Trajnime Gjyqësore (EJTN), përmes Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, në Tallin të Estonisë, u mbajt trajnimi në temën: “Aplikimi i të Drejtës së BE-së kundër Diskriminimit” që u realizua me bashkë organizim në mes të ERA-dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Estonisë.

Me përkrahjen financiare të Gjykatës Kushtetuese, në këtë trajnim morën pjesë: Jurist-consulti z. Sevdail Kastrati dhe Këshilltari i lartë kushtetues-juridik z. Boban Petković. Temat dhe aspektet e mbuluara gjatë këtij trajtimi dy-ditor ishin: Kuadri ligjor i BE-së me konceptet kryesore: diskriminimi direkt, diskriminimi indirekt, ngacmimi, Barra e provës, Procedura e vendimit

paraprak; Aftësia e kufizuar dhe trajtimi i arsyeshëm, Diskriminimi fetar në vendin e punës, Të drejtat LGBTIQ, Gjuha e urrejtjes, Inteligjenca artificiale.

Seminari ka qenë i një rëndësie të jashtëzakonshme për pjesëmarrësit nga Republika e Kosovës sepse atyre ua ka mundësuar ta trajtojnë çështjen e (mos) diskriminimit nga një nivel më i lartë i kuadrit ligjor Juridik se sa ai që mbulohet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nga legjislacioni i BE-së dhe nga rastet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë që është edhe kuadër më i gjerë ligjor e edhe më kompleks në mënyrën e trajtimit të rasteve konkrete.

Punëtori e EJTN në temën: Të Drejtat e Njeriut dhe Qasja në Drejtësi në BE

Me 26-28 shtator 2022, nën organizimin e Rrjetit Evropian për Trajnime Gjyqësore (EJTN), përmes Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, u realizua punëtorja “Të Drejtat e Njeriut dhe Qasja në Drejtësi në BE”, e cila u mbajt në ambientet e Këshillit të Evropës në Strasburg, Francë.

Këshilltarët juridik nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Bardh Bokshi dhe Resmije Loshi kanë marrë pjesë dhe janë trajnuar lidhur me çështjet në vijim: (i) prezantim i karakterit të përgjithshëm të punës dhe veprimtarisë së “Rrjetit Evropian për Trajnim Gjyqësor” (EJTN); (ii) pavarësia e gjyqësorit si standard evropian; dhe, (iii) e drejta për qasje në gjykatë, me theks në jurisprudencën më të freskët të GJEDNJ-së.

Këshilltarët Bardh Bokshi dhe Resmije Loshi po ashtu kanë marrë pjesë në seancën dëgjimore (chamber hearing) të zhvilluar nga Dhoma e GJEDNJ-së në përbërje nga shtatë (7) gjyqtarë, në rastin jashtëzakonisht interesant Pietrzak

kundër Polonisë dhe Bychawska-Siniarska dhe të tjerët kundër Polonisë, që në thelb shqyrtonte të drejtën e shtetit polak për të përgjuar dhe kontrolluar përmbajtjen e diskutimeve profesionale ndërmjet avokatëve dhe klientëve të tyre, pra, nëse shteti polak kishte të drejtë të ndërhynte në privatësinë e ankuesve në njërin anë, ndërsa në anën tjetër, të drejtën e ankuesve për t’u ankuar kundër masave përgjuese të shtetit polak si dhe mundësinë e shikimit të materialit të regjistruar nga masat përgjuese.

Këshilltarët Bardh Bokshi dhe Resmije Loshi po ashtu kanë marrë pjesë në trajnime grupore me raste individuale lidhur me pavarësinë e gjyqësorit me ç’rast kanë dhënë kontributin e tyre për temën në fjalë bazuar në përvojën e punës në Gjykatën kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe kanë mësuar dhe thelluar njohuritë e tyre edhe nga shkëmbimi i përvojave me pjesëmarrësit tjerë në punëtorinë “Të Drejtat e Njeriut dhe Qasja në Drejtësi në BE.”

Java e Ndërmjetësimit



Me 20-26 shtator Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Zyrën për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit/ Shërbimi Amerikan i Ndërmjetësimit dhe Partimit shënoi Javën e Ndërmjetësimit, përmes organizimit të një tryeze të rumbullakët për prokurorë, gjyqtarë, avokatë dhe ndërmjetësues. Diskutimi i zhvilluar në këtë tryezë do të shërbejë si forum për shkëmbimin e informacionit dhe

promovimin e përdorimit të metodave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim në lëndë penale, si dhe punën e Odës së Ndërmjetësuesve.

Tryeza e rumbullakët u zhvillua përmes diskutimeve të hapura, të moderuara, për tema relevante, ku pjesëmarrësit ndanë mendimet, sukseset, sfidat dhe perspektivat e tyre për ndërmjetësimin në rastet penale.

Përmbledhja e informatave dhe të gjeturave nga kjo tryezë është thelbësore dhe priten të ndihmojnë shumë në planifikimin dhe përshtatjen e aktiviteteve tona, duke ecur përpara me ndërmjetësimin në lëndë penale.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar, grupi I- gjenerata (IX)



Gjatë muajit shtator për grupin e I të gjyqtarëve të sapo emëruar (29), gjenerata e IX janë realizuar gjithsej 40 sesione trajnuese nga modulet: Kod Penal i Republikës së Kosovës, Shkathësitë personale dhe ndërpersonale, Kodi i Procedurës Penale si dhe nga moduli Rendi Juridik Kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të modulit: Kodi Penal i Republikës së Kosovës janë realizuar sesione trajnuese nga nën moduli “Krimi kibernetik” 4 sesione ndër të cilat janë trajtuar: Shoqëria e informacionit dhe krimi kibernetik; Teknologjia, pajisjet digjitale dhe provat elektronike. Nga nën moduli “Përgjegjësia e personave juridik” janë trajtuar 2 sesione me temat: Përgjegjësia penale e personit juridik dhe kuptimi i personit juridik si dhe baza dhe kufiri i përgjegjësisë së personit juridik. Nga nën moduli “Kodi Penal-pjesa e veçantë” është realizuar 1 sesion trajnues nga i cili u trajtua korrupsioni zyrtar.

Në kuadër të modulit: Shkathësitë personale dhe ndërpersonale, janë realizuar 4 sesione trajnuese nga nën moduli “Menaxhimi i rasteve dhe vlerësimi i performancës” në të cilat janë trajtuar: Rëndësia dhe parimet e menaxhimit dhe i rrjedhës së lëndës; Qëllimi i punës së gjykatave dhe metodat themelore në menaxhimin e lëndëve si dhe kontrolli i shtyrjes; Udhëheqësia dhe masat e performancës në gjykatë; Vlerësimi

i performancës në gjykatë dhe Komisioni i vlerësimit të performancës së gjyqtarëve.

Në kuadër të modulit: Kodi i Procedurës Penale, janë realizuar 2 sesione trajnuese nga nën modulet: “Procedura paraprake” ku janë trajtuar: procedura penale dhe roli i gjyqtarit në procedurë. Nga nën moduli: “Roli i gjyqtarit në Procedurën paraprake” janë realizuar 5 sesione trajnuese me ç’ rast janë trajtuar: Roli i gjyqtarit në procedurën paraprake; Caktimi i masës së paraburgimit të pandehurit në procedurë, kontrollimi i personit sendit dhe objektit; Sekuestrimi i përkohshëm dhe konfiskimi sipas kompetencave të zgjeruara. Nga nën moduli: “Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit” janë realizuar 3 sesione trajnuese me temat: Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit në procedurën penale; Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit sipas Kodit të Procedurës Penale dhe procedurat lidhur me masat e fshehta. Nga nën moduli: “Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit” është trajtuar 1 sesion me temë: thirrja, urdhër arresti dhe premtimi i të pandehurit që nuk do ta braktis vendqëndrimin. Nga nën moduli: “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit” janë trajtuar 3 sesione dhe janë trajtuar: Të dëmtuarit në kuptim të përgjithshëm; Kuptimi i përgjithshëm i dëshmitarit dhe të kuptuarit e dëshmitarit bashkëpunues. Nga nën moduli: “Parimet kompetencat dhe përjashtimi i gjyqtarit nga procedura penale” janë realizuar 2 sesione dhe janë trajtuar: Parimet në procedurën penale dhe kompetencat e gjykatës në procedurën penale. Nga nën moduli: “Shqyrtimi fillestar dhe i dytë” janë trajtuar 3 sesione me temë: Shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe kundërshtimi i provave; Kërkesa për hedhjen e aktakuzës dhe shqyrtimi i dytë. Nga nën moduli: “Shqyrtimi gjyqësor” janë realizuar 2 sesione me temë: Shqyrtimi gjyqësor dhe zbatimi i shqyrtimit gjyqësor dhe parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Nga nën moduli: “Prokurori i shtetit, i pandehuri dhe i dëmtuari në procedurën penale” janë realizuar 3 sesione me temë: Prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi në procedurën penale dhe i dëmtuari në procedurën penale. Nga nën moduli: “Procedura e kryesve me çrregullime mendore” është realizuar 1 sesion nga i cili u trajtua përgjegjësia penale e personit juridik. Në kuadër të modulit Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar janë realizuar 4 sesione trajnuese

nga nën moduli “E drejta e Be-së” nga i cili janë trajtuar: Roli dhe kompetencat e institucioneve të BE-së; Vendimmarrja në BE; Burimet e së drejtës së BE-së dhe qytetaria e Bashkimit Evropian dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Metodologjia e zhvillimit të trajnimit është zbatuar me raste praktike duke trajtuar shembuj dhe me anë të metodës së bashkëbisedimit.



Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar, grupi II- gjenerata (IX)



Gjatë muajit shtator për grupin e dytë të gjyqtarëve të sapo të sapo emëruar (18), gjenerata e IX janë realizuar gjithsejtë 40 sesione trajnimi teorik nga modulet: Shkathësitë personale dhe ndërpersonale dhe E drejta civile, administrative dhe ekonomike.

Në kuadër të modulit: Shkathësitë personale dhe ndërpersonale, janë realizuar 4 sesione trajnuese nga nën moduli “Menaxhimi i rasteve dhe vlerësimi i performancës” në të cilat janë trajtuar: Rëndësia dhe parimet e menaxhimit dhe i rrjedhës së lëndës; Qëllimi i punës së gjykatave dhe metodat themelore në menaxhimin e lëndëve si dhe kontrolli i shtyrjes; Udhëheqësia dhe masat e performancës në gjykatë; Vlerësimi i performancës në gjykatë dhe Komisioni i vlerësimit të performancës së gjyqtarëve.

Në kuadër të modulit: E drejta civile, administrative dhe ekonomike janë realizuar 7 sesione trajnuese nga nën moduli “ E drejta e detyrimeve” në të cilin janë trajtuar çështjet si: Shkaktimi i dëmit si burim i detyrimeve; Shpërblimi i dëmit; Pasurimi i pa bazë; Gjerimi i punëve të huaj pa porosi dhe shprehja e njëanshme e vullnetit; Parashkrimi; Mjetet reale dhe personale për sigurimin e ekzekutimit të kërkesave; Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, kontrata për shitjen dhe kontrata mbi qiranë.

Nga nën moduli: Pjesa kontestimore-pjesa e dytë janë realizuar 12 sesione trajnuese në të cilat janë trajtuar çështjet si: Paraqitja e padisë në

gjykatën e shkallës së parë; Shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgjigja në padi; Bashkëndërgjyqësia dhe pjesëmarrja e personave të tretë në gjykim; Seanca përgatitore dhe pajtimi gjyqësor; Seanca për shqyrtim kryesor; Mjetet provuese dhe marrja e provës; Dëshmitarët ekspertët dhe palët; Sigurimi i kërkesëpadisë; Ndërprerja dhe posedimi i procedurës; Procedurat e posaçme kontestimore; Simulimi i seancës përgatitore dhe Simulimi i seancës së shqyrtimit kryesor.

Nga nën moduli “ E drejta administrative ” është realizuar 1 sesion trajnues, me temë: E drejta e procedurës administrative.

Nga nën moduli “E drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të përafërta” janë realizuar 7 sesione trajnuese me ç’ rast janë trajtuar çështjet si: E drejta e pronësisë; Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët; Mënyra e fitimit të drejtës së pronësisë; fitimi derivativ dhe origjiner i së drejtës së pronësisë; Fitimi i pronësisë në mënyrë derivative; Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë; Të drejtat sendore në sendet e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore, dhe mbrojtja e servituteve sendore; Posedimi dhe mbrojtja e posedimit dhe Pengu, hipoteka, barra sendore dhe e drejta e ndërtimit.

Nga nën moduli “ E drejta familjare ” u realizuan 5 sesione trajnuese dhe u trajtuan temat si: E drejta familjare, kuptimi i familjes, burimet e të drejtës familjare, gjinia dhe llojet e gjinisë; E drejta martesore, zgjidhja e martesës, procedura e shkurorëzimit, detyrimi për ushqim dhe e drejta prindërore; Format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror; Kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë apo i atësisë; Marrëdhëniet pasurore në mes të bashkëshortëve dhe Dhuna në familje.

Nga nën moduli “ Procedura jo kontestimore ” janë realizuar 4 sesione trajnuese në të cilat janë trajtuar çështjet si: Dispozitat e përgjithshme të ligjit të procedurës kontestimore; Rregullimi i gjendjeve personale dhe familjare; Rregullimi i marrëdhënieve pasurore, administrimi dhe shfrytëzimi i sendit të përbashkët dhe Hartimi i

vendimit në procedurën jokontestimore, dhe mjetet juridike.

Metodologjia e trajnimit për këtë grup është realizuar me anë të metodës së bashkëbisedimit si dhe me anë të rasteve praktike.



Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e IX)



Për 6 prokurorët e sapo emëruar janë zhvilluar aktivitete në drejtim të përmbushjes së programit të trajnimit teorik dhe trajnimit praktik. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej 16 sesione trajnimi nga dy modulet: Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe Shkathësitë personale dhe ndërpersonale.

Nga nën moduli: “Kodi Penal-pjesa e përgjithshme” janë realizuar 8 sesione trajnuese me ç’rast janë trajtuar çështjet si: Nocionit dhe elementet bazë të veprës penale; Vepra penale dhe përgjegjësia penale; Mbrojtja e nevojshme; Dhuna dhe kanosja; Dashja dhe pakujdesia si dhe Lajthimi dhe bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale.

Nga nën moduli: “Kodi Penal-pjesa e veçantë” janë realizuar 2 sesione trajnuese nga të cilat janë trajtuar veprat penale kundër pasurisë dhe veprat penale kundër jetës dhe trupit.

Nga moduli për Shkathësitë personale dhe ndërpersonale janë realizuar 6 sesione trajnuese për Etikën profesionale dhe përgjegjësinë disiplinore”. Në kuadër të këtyre sesioneve u trajtuan çështjet si: Kodi i Etikës Profesionale për Prokurorë; Parimet bazë të Etikës Profesionale, Integriteti, llogaridhënia dhe transparenca; Procedura disiplinore për prokurorë dhe procedura disiplinore ndaj prokurorëve.

Metodologjia e zbatuar gjatë trajnimit teorik është realizuar me raste praktike dhe metodën interaktive.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe 12 ditë trajnimi praktik në prokurori konform orarit dhe kalendarit trajnues për këtë gjeneratë.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimet për Risitë e Kodit të Procedurës Penale



Me 02-03 shtator, 09-10 shtator si dhe 16-17 shtator 2022, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, për regjionin e Mitrovicës, Prizrenit dhe Prishtinës janë realizuar 3 trajnime për “Risitë e Kodit të Procedurës Penale”

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte njoftimi i gjyqtarëve dhe prokurorive duke përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor lidhur me Risitë e Kodit të Procedurës Penale, të cilat kanë tendencë për ndryshime të nevojshme dhe efektive.

Trajnimet u orientuan në trajtimin dhe shpjegimin sa i përket Mbrojtës së detyruar, mbrojtësit me shpenzime publike dhe kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës.

Më tej është vazhduar me hedhjen e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar aktvendimin, masat e veçanta hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake, mundësia hetuese e veçantë, hetimi (afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve).

Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatave dhe prokurorive.

Në këtë trajnim u trajtua edhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit.

Ndër të tjera u shtjellua edhe Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor duke u vazhduar me standardin e rishikimit të ankesave shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe procedura penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike.

Pjesëmarrës në këtë trajnim nga regjioni i Mitrovicës ishin: 15 Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, 11 prokurorët nga Prokuroria Themelore si dhe 9 avokat dhe 1 mbrojtës i viktimave nga regjioni i Mitrovicës.

Pjesëmarrës në këtë trajnim nga regjioni i Prizrenit ishin: 11 Gjyqtarët e Gjykatave Themelore, 11 Prokurorët e Prokurorive Themelore si dhe 8 avokat dhe 2 mbrojtës të viktimave.

Pjesëmarrës në këtë trajnim nga regjioni i Prishtinës: 16 gjyqtarë, (3 nga Gjykata e Apelit dhe 13 nga Gjykatat Themelore), 11 Prokurorët e Prokurorive Themelore, (1 nga PRSK, 2 nga Apeli dhe 9 të tjerë nga niveli themelor) si dhe 9 avokat dhe 2 mbrojtës të viktimave.

Trajnim: Skemat pensionale të financuar sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës

Më 06 Shtator 2022, Akademia e Drejtësisë kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar Trajnimin me temë “Skemat pensionale, të financuar sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zbatimin e unifikuar të legjislacionit në fuqi për pensione.

Gjatë këtij trajnimi është diskutuar për trajtimin e skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, si pensione të Shtyllës së parë, llojet e skemave pensionale, kriteret për plotësimin e kushteve për të qenë përfitues për secilën nga 6 skemat pensionale, po ashtu janë shpjeguar edhe procedura administrative para organeve administrative.

Një diskutim i rëndësishëm është zhvilluar lidhur me komisionin mjekësor të caktuar nga

organi administrativ të pensionet e aftësisë së kufizuar, marrja e provave përmes ekspertizës, vlera e ekspertizës së organit administrativ, roli i kësaj ekspertize në vendimmarrje nga Gjykata.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 5 gjyqtarët që ishin nga radhët e departamentit administrativ dhe departamentit të përgjithshëm të Gjykatave Themelore, 1 bashkëpunëtorë profesional nga gjykata si dhe 12 zyrtarë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.



Program i Specializuar i Trajnimit-Krimi i Organizuar –Sesioni III

Më 6-07 Shtator 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë Program i Specializuar i Trajnimit Krimi i Organizuar – Sesioni III.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve për krimin e organizuar dhe ndërlidhjen e tij me korrupsionin, dhe terrorizmin si dhe për strategjinë kombëtare në luftimin e këtyre veprave për zgjidhjen e drejtë dhe në mënyrë meritorë të rasteve në gjykata.

Për dy ditë me radhë trajnimi u fokusua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme të krimit të organizuar me theks te konfiskimi i pasurisë së fituar me anë të veprës penale, sanksionet penale kundër kryerësve të veprave penale të krimit të organizuar, lidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizimit si dhe për strategjinë kombëtare kundër krimit të organizuar. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe sfidave në hetimin e këtyre rasteve, veçanërisht pengesat legjislative dhe institucionale, mungesa e informatave, ndikimet e jashtme si dhe në zbulimin e aseteve dhe konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme.

Me rastin e këtij trajnimi u elaboruan teknikat e veçanta hetimore me theks te masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit duke vënë në pah llojet,

kushtet, personat kompetent për të lëshuar këto masa, përmbajtja dhe kohëzgjatja e urdhrave për lëshim të masave, ndihma e organeve tjera për zbatimin e këtyre masave, mënyra e dorëzimit të shkresave si dhe raportet tek palët lidhur me këto masa në procedurë.

Pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të rasteve të krimit të organizuar në shumë vende dhe për mënyrën se si i janë qasur hetimeve dhe gjykimit të këtyre rasteve institucionet e zbatimit të ligjit te shtetet përkatëse. Po ashtu përmes një video incizimi edhe një rast të krimit të organizuar të ndodhur në Shqipëri duke i'u mundësuar të njihen për së afërmi me mënyrën e zhvillimit të krimit të organizuar, format dhe ndihmën e grupeve kriminale dhe veprimtarinë e organizatave kriminale.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 11 gjyqtarë që vinin nga radhët e departamentit për krime të rënda , departamentit special si dhe departamentit të përgjithshëm, 4 prokurorë, 1 prej tyre nga niveli i Apelit dhe tre tjerët nga niveli themelor.



Trajnim: Zbatimi i të drejtave pronësore intelektuale



Më 07-08 Shtator 2022, me Mbështetjen e BE-së për të Drejtat Pronësore Intelektuale në Kosovë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Zbatimi i të Drejtave Pronësore Intelektuale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve mbi bazat ligjore dhe standardet ndërkombëtare dhe të BE-së për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në ditën e parë trajnimi u fokusua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme të drejtave të pronësisë intelektuale në mjedisin dixhital dhe çështjet e përgjegjësisë për shkeljet online apo në internet, për artet e aplikuara sipas legjislacionit të DPI-së, shkeljet e veprave arkitekturore si dhe për jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE) lidhur me zbatimin e DPI-së në mjedisin dixhital dhe lidhur me zbatimin e DPI-ve.

Në ditën e dytë gjyqtarët dhe profesionistët tjerë ligjor pjesëmarrës janë ndarë në dy grupe dhe kanë vijuar trajnimin me përmbajtje adekuate varësisht nga kompetenca dhe juridiksioni që kanë përfaqësuar.

Në grupin e parë ishin gjyqtarët nga Departamenti i Çështjeve Komerciale dhe Administrative, ndërkaq në grupin e dytë Divizioni për Çështjet Penale të Gjyqtarëve si dhe zyrtarë policor dhe profesionistë tjerë ligjor nga Departamenti i Krimeve Ekonomike.

Në ditën e dytë për grupin e parë trajnimi është fokusuar në procedurat e shfuqizimit të DPI-ve, përjashtimet dhe kufizimet e të drejtave të autorit, korniza ligjore ndërkombëtare dhe e BE-së, shkeljet e të drejtave nga marka tregtare si dhe shkeljet e të drejtave nga patenta. Në fund edhe ushtrime nga praktika për mënyrën e zbatimit të drejtës së pronësisë intelektuale.

Në ditën e dytë për grupin e dytë të pjesëmarrësve trajnimi u fokusua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme të piraterisë, falsifikimit dhe kontrabandës së produkteve të mbrojtura nga DPI – kornizës ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare, hetimit të shkeljeve të IPR në mjedisin dixhital - Kutia e mjeteve dhe sfidat e hetuesve, hetimit të krimeve të DPI-së - Grackat dhe Udhëzimet, dënimet penale për shkeljet e DPI-ve, krimin të organizuar dhe gjithashtu në fund ushtrime praktike përmes rasteve të hetimit të shkeljeve të DPI-ve me fokus të veçantë në shkeljet online.

Pjesëmarrësit shqyrtuan praktikën gjyqësore përkatëse dhe praktikën më të mira për shkeljet e të drejtave të Pronësisë Intelektuale, duke përfshirë të drejtat e autorit dhe të drejtat e pronësisë intelektuale.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike në zbatimin e të drejtës së autorit dhe markave tregtare.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 12 gjyqtar të cilët ishin kryesisht nga Gjykata Komerciale, nga departamenti i përgjithshëm i Gjykatave Themelore, 1 prokuror si dhe 4 zyrtarë policor, 1 zyrtarë doganor si dhe 2 zyrtarë nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Program i Specializuar i trajnimit-Krimi kibernetik dhe kriptovalutat-Sesioni II

Më 13-15 Shtator 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit - Krimi Kibernetik dhe kriptovalutat – Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njoftohen për së afërmi me Krimin kibernetik si vepër penale në legjislacionin e brendshëm, procedurat dhe praktikën në lidhje me provat elektronike si dhe për kriptovalutat për zgjidhjen meritorë të rasteve në praktikën gjyqësore.

Krimi kibernetik është një fenomen që prek një sërë kompetencash, si ato në fushën e informatikës, energjetikës, kriminologjisë, ekonomisë, mjekësisë, drejtësisë si dhe shumë fusha tjera. Përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe veçanërisht i Internetit ka marrë një rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Ky fenomen prek jo vetëm aktivitetet e një organizmi qoftë ai shtetëror apo privat, i implikuar në sferën e biznesit apo të një aktiviteti jo fitimprurës, por mund të prekë dhe njeriun e thjeshtë në aktivitetin e tij të përditshëm, në sferën e tij private apo profesionale. Si çdo teknologji e re e vënë në dispozicion të një numri të madh përdoruesish, Interneti paraqet jo vetëm të mira dhe përfitime, por në të njëjtën kohë dhe një sërë problemesh. Duke qenë një teknologji “e liberalizuar” prej disa kohësh,

s’ka diskutim se përfitimet që sjell përdorimi i kësaj teknologjie janë të mëdha.

Trajnimi u fokusua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme procedurale të trajtimit të veprave penale dhe masave hetimore sipas legjislacionit të brendshëm, duke pas në konsideratë edhe në legjislacionin ndërkombëtar dhe veçanërisht Konventën e Budapestit si dhe Bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë.

Fokus të theksuar në këtë trajnim ishin sfidat që hasin prokurorët dhe gjyqtarët gjatë trajtimit të rasteve të krimit kibernetik, zbatimi i dispozitave materiale në përgjithësi, e në veçanti vepra penale: pornografia me fëmijë, gjegjësisht të gjitha format e kryerjes së kësaj veprë por edhe veprat penale të shfrytëzimit seksual ku subjekt janë fëmijët (ndjeshmëria dhe rëndësia e tyre), bashkëpunimin me ofruesit e shërbimeve, ruajtja e përsheptuar e të dhënave të rastet urgjente, si dhe parashtrimin e kërkesave për ndihmë juridike-ndërkombëtare.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 8 gjyqtarë nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Themelore, 2 prokuror nga Prokuroria Themelore si dhe 5 ekspertë nga PSRK.



Fillimi i Trajnimeve nga Fusha e së Drejtës Komerciale



Me qëllim të fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale të Gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale, Akademia e Drejtësisë nga data 14-16 shtator, në bashkëpunim me partnerin e saj Projektin e USAID për Drejtësi Komerciale, ka zhvilluar Trajnimet e para nga fusha e të Drejtës Komerciale, për Gjyqtarët e kësaj Gjykate.

Këto trajnime janë si rezultat i një procesi të gjatë të zhvilluar nga Akademia e Drejtësisë dhe USAID, për rekrutimin e trajnuesve të specializuar nga kjo fushë, me ç'rast të njëjtit do t'i zhvillojnë trajnimet sipas temave të përcaktuara, për Gjyqtarët dhe stafin tjetër të Gjykatës Komerciale.

Meqenëse Trajnimi ishte 3 ditor, në ditën e parë u trajtua Procedura e Falimentimit, çështjet e ndërmarrjeve publike, kërkesat për falimentim, Procedura e likuidimit, dallimet mes procedurës së falimentimit dhe likuidimit.

Në ditën e dytë trajnimi u fokusua tek Pronësia Inelektuale, Markat Tregtare, Patentat. Meqenëse tema ishte mjaft e gjerë dhe nuk mund të përmbledhej vetëm brenda një dite, u prekën

vetëm pikat kyçe si: Llojet e pronësisë intelektuale, kushtet e regjistrimit të një marke tregtare, të drejtat e autorit, dizajni industrial, patentat, mbrojtja juridike e të drejtave të pronësisë intelektuale etj.

Në ditën e tretë dhe të fundit u trajtuan çështjet e Zbatimit dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtare, direktivave dhe rregulloreve të UE-së, mbi çështjet komerciale, fiskale dhe doganore, në veçanti ndryshimet Legjislative me Ligjin e ri të së Drejtës Ndërkombëtare Private.

Trajnimet nga fusha Komerciale pritet të kenë vazhdojnë edhe javët në vijim, ku pritet të trajtohen edhe temat tjera nga Fusha Përmbartimore, Tatimore, Fiskale etj.

Përfitues të trajnimit ishin 10 Gjyqtarët e rinj të Gjykatës Komerciale.

Trajnim: Zbatimi i nenit 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut



Më 14 shtator 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “Zbatimi i Nenit 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive për të drejtën e jetës dhe zbërthimi e interpretimi i gjerë i mbrojtjes së të drejtës në jetë si dhe zbatimi i praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në këtë tematikë.

Në këtë trajnim në pjesën e parë u trajtuan obligimet e shtetit për të respektuar të drejtën e jetës dhe detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur individët nën mbikëqyrjen e tyre, interpretimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) lidhur me aspektet procedurale të së drejtës për jetën dhe pacenueshmëria e jetës si e drejtë absolute e njeriut.

Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan raste dhe situata kur jeta konsiderohet e privuar në kundërshtim me këtë nen dhe kur nuk konsiderohet e privuar në kundërshtim me këtë nenë, në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, i bërë absolutisht i domosdoshëm dhe zbatimi i drejtë i kriterëve që përmbahen në dispozitat e nenit 2 të KEDNJ.

Në këtë trajnim u paraqiten shpjegime për rëndësinë dhe garantimin e kësaj të drejte me dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e

njeriut, garantimi kushtetues dhe presupozimi i saj duke garantuar pacenueshmërinë e integritetit trupor, qoftë me mbrojtjen e pakusht të jetës, pra ndalimin absolut të dënimit me vdekje. Gjithashtu u trajtuan dilemat rreth natyrës themelore të “mos-derogueshmërisë” së kësaj të drejte”, elementet përmbajtësore të së drejtës për jetën dhe obligimet e shtetit për mbrojtjen e individëve të cilët mbahen nën mbikëqyrjen e tij në bazë të KEDNJ. Shqyrtimi u fokusua edhe mbi detyrimin e përgjithshëm për të mbrojtur të drejtën për jetë “me ligj” dhe ndalimi i privimit të jetës që rrethohet nga një listë përjashtimesh.

Ishte konkludim i përgjithshëm se e drejta në jetë, e mbrojtur me nenin 2 të KEDNJ, me Protokollin 6., mbi heqjen e dënimit me vdekje në kushte paqësore, me Protokollin nr.13., mbi heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat, është njëra ndër të drejtat themelore e garantuar me KEDNJ dhe se shkelja e saj konsiderohet si shkelje më e rëndë e Konventës.

Në Republikën e Kosovës mbrojtja e kësaj të drejte bie në organet e ndjekjes penale: policisë, prokurorisë së shtetit, gjykatave të rregullta, si atyre që zhvillojnë procedurën penale në shkallë të parë, ashtu edhe atyre që vendosin për ankesat kundër aktgjykimeve të shkallës së parë ose mjeteve të jashtëzakonshme juridike të lejuara në kontekstin e çështjeve juridiko-penale.

Në vazhdim u konkludua se shteti ka si detyrim mbrojtjen e individëve të cilët mbahen nën mbikëqyrje apo nën kontroll dhe për këtë arsye këta persona janë në pozitë të ndjeshme në lidhje me shtetin.

Gjithashtu u konkludua se për GJEDNJ nuk ka rëndësi nëse shkelja e Konventës është bërë nga organe me karakter legjislativ, administrativ apo gjyqësor. Për të përgjegjësia për shkeljen e Konventës ka karakterin e një përgjegjësie ndërkombëtare të shtetit, përderisa ai si subjekt i së drejtës ndërkombëtare është Palë e Lartë Kontraktuese në KEDNJ dhe në bazë të Nenit 1 të Konventës ka marrë përsipër që të garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore e GJEDNJ duke u

shoqëruar me diskutime interaktive. Gjithashtu pjesëmarrësit punuan të ndarë në grupe në analizën e një rasti hipotetikë duke zbërthyer dispozitat e nenit 2. të KEDNJ dhe kërkesave që përmbajnë këto dispozita.

Përfitues në këtë trajnim ishin 27 gjyqtarë që vinin nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit si dhe nga niveli themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës si dhe 2 prokurorë, një nga Apeli dhe një nga niveli themelor.

Trajnim: Si të përmirësohet efikasitetit i gjykatës duke përdorur mjetet e CEPEJ dhe treguesit e performancës

Më 14 dhe 15 shtator 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës: „Forcimi i Cilësis dhe Efikasitetit të Drejtësisë (Veprimi KoSEJ II)” në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Si të përmirësohet efikasitetit i gjykatës duke përdorur mjetet e CEPEJ dhe treguesit e performancës”

Qëllimi i këtij trajnimi është njohja me standardet dhe mjetet e CEPEJ si dhe treguesit e performancës që përdoren në BE për përmirësimin e efikasitetit në gjykata dhe adoptimi i tyre në kontestin e Kosovës.

Trajnimi fillimisht u fokusua në prezantimin e punës së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) dhe grupit të tij të punës. Gjithashtu në prezantimin e raportit statistikor të CMII dhe paisjeve. Në vijim u vazhdua me mjetet e CEPEJ-it - mënyrat për të përmirësuar performancën e gjykatës me theks te manualët mbi statistikën e gjyqësorit, menaxhimit të kohës në gjyqësor, afatet kohore, peshimi i

rasteve, vlerësimin e sistemeve të databazës dhe pasijet si dhe për drejtësinë kibernetike.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësinë e njoftimit edhe me treguesit kyç të performancës nga CEPEJ, dobitë e përdorimit të treguesve nga gjyqtarët mbikëqyrës si dhe me vendimet mbi të dhënat e disponueshme në gjykatë për të përmirësuar performancën.

Në fund u realizua edhe një punë në grupe në kalkulimin dhe analizën e treguesve kyç të performancës së gjykatës dhe në këtë mënyrë për së afërmi u identifikuan saktë përparësitë në zbatimin e standardeve të CEPEJ-it dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e efikasitetit në drejtësi.

Ditën e parë këtë trajnim e kanë vijuar 17 gjyqtarë dhe 10 staf administrativ ndërkaq në ditën e dytë 2 gjyqtarë dhe 14 staf administrativ nga gjykatat që vinin nga radhët e administratorëve, ndihmës administratorëve si dhe referentë, dhe zyrtarë nga gjykatat.



Trajnim: Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë

Më 16 Shtator 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth aplikimit të dispozitave ligjore që i referohen shqyrtimit filleshtar, shqyrtimit të dytë dhe shqyrtimit gjyqësor.

Gjatë këtij trajnimi është diskutuar për shqyrtimin gjyqësor që konsiderohet faza më e rëndësishme e procedurës penale dhe që të zhvillohet me sukses dhe pa pengesa, nevojitet që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në fillim të bëjë përgatitje të caktuara. Përgatitje kanë të bëjnë me caktimin e shqyrtimit gjyqësor, me çështje tjera përgatitore, siç janë: dërgimi i ftesave të akuzuarit, mbrojtësit, të dëmtuarit, dëshmitarëve, ekspertëve. Njëherit shqyrtimi gjyqësor, parimisht është i hapur për publikun dhe po ashtu në të mund të marrin pjesë vetëm personat madhor, të cilët

kanë të drejtë që të përcjellin gjithë rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor.

Më tutje janë trajtuar temat që kanë të bëjnë me përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor, publicitetin e shqyrtimit gjyqësor, zbatimin e shqyrtimit gjyqësor, parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, gjykimin në mungesë, shtyerjen, ndërprerjen dhe afatet e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, prezentimin (paraqitjen) e provave, fjalën përfundimtare, etj.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 20 gjyqtarë dhe 1 prokurorë nga niveli Themelor.



Trajnim: Vazhdimi i Trajnimeve nga fusha Komerçiale

Nga data 21-24 shtator 2022, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me partnerin e saj USAID, projekti i Drejtësisë Komerçiale, ka vazhduar me sesionin e II-të të trajnimeve nga fusha Komerçiale, për Gjyqtarët e Gjykatës Komerçiale.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve të kësaj Gjykate.

Meqenëse Sesioni i II-të ishte katër (4) ditor, sesionet janë ndarë në 4 module trajnuese që përfshinin temat si:

Specifikat e së drejtës fiskale, tatimore dhe doganore;

Procedura Përmbartimore;

Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare;

Implikimet praktike të ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Gjyqtarët patën mundësinë të mësojnë më shumë rreth specifikave doganore, deklaratimet doganore, juridiksioni i Gjykatës Komerçiale në trajtimin e çështjeve fiskale etj. Gjithashtu, u trajtuan edhe shumë tema nga fusha e industrisë bankare, llojet e institucioneve financiare, kompanitë e sigurimeve.

Në ditën e III-të dhe IV u trajtuan më shumë Procedurat e përmbartimit, titujt përmbartimor, prapësimi, llojet e shoqërive tregtare, organizimi i tyre etj.

Akademia e Drejtësisë synon që brenda këtij viti të vazhdojë edhe me trajnime tjera nga fusha komerciale, me qëllim të përgatitjes së gjyqtarëve në mënyrë sa më profesionale, gjithmonë duke u bazuar në kurrikulën e saj trajnuese.

Përfitues të trajnimit ishin 10 Gjyqtarët e Gjykatës Komerçiale.



Trajnim: Qasja në drejtësi për grupet e cenusshme-penale

Më 23 Shtator 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Trajnim për qasje në drejtësi për grupet e cenusshme-penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët të avancojnë njohuritë për ligjet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut për mbrojtjen e tyre gjyqësore konform legjislacionit në fuqi përmes vendimeve në mënyrë meritore.

Trajnimi fillimisht u fokusua në trajtimin e kornizës ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes. Vëmendje të veçantë kishte korniza ligjore dhe institucionale e Kosovës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë e cila siç u tha siguron një bazë të fortë për promovimin e respektimit të të drejtave individuale dhe grupore. Përveç kësaj u vunë në pah Strategjitë dhe programet për zbatimin e këtyre të drejtave të cilat kanë në fokus promovimin edhe më tej të drejtave dhe qasjen e barabartë në tregun e punës për komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian.

Në vazhdim me rastin e këtij trajnimi u trajtua edhe korniza ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për dhunën në familje të motivuar nga njëanshmëria për identitetin gjinor dhe orientimin seksual si dhe për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrësit patën rastin që përmes ushtrimeve praktike dhe ofrimit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut të njohin edhe më tej standardet për mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenusshme.

Në pjesën e pasdites, trajnimi u fokusua në stereotipet, paragjykimet dhe llojet e përkatësisë etnike të bazuar në diskriminimin me fokus të veçantë te romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 3 prokurorë si dhe 18 staf administrative që vinin nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional si dhe zyrtarë tjerë nga gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës.



Trajnim: Qasja në drejtësi për grupet e cenueshme-civile

Më 23 Shtator 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Trajnim për qasje në drejtësi për grupet e cenueshme-civile”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët të avancojnë njohuritë për ligjet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut për mbrojtjen e tyre gjyqësore konform legjislacionit në fuqi përmes vendimeve në mënyrë meritore.

Trajnimi fillimisht u fokusua në trajtimin e kornizës ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes. Vëmendje të veçantë kishte korniza ligjore dhe institucionale e Kosovës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë e cila siç u tha siguron një bazë të fortë për promovimin e respektimit të të drejtave individuale dhe grupore. Përveç kësaj u vunë në pah Strategjitë dhe programet për zbatimin e këtyre të drejtave të cilat kanë në fokus promovimin edhe më tej të drejtave dhe qasjen e barabartë në tregun e punës për komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian.

Në vazhdim me rastin e këtij trajnimi u trajtua edhe korniza ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për dhunën në familje të motivuar nga njëanshmëria për identitetin gjinor dhe orientimin seksual si dhe për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrësit patën rastin që përmes ushtrimeve praktike dhe ofrimit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut të njohin edhe më tej standardet për mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenueshme.

Në pjesën e pasdites, trajnimi u fokusua në stereotipet, paragjykimet dhe llojet e përkatësisë etnike të bazuar në diskriminimin me fokus të veçantë te romët, ashkalinj dhe egjiptasit

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 2 gjyqtarë si dhe bashkëpunëtorë profesional nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Ferizajit.



Hetimi financiar/ Trajnim per Prokuroret e Prokurorise Themelore të Prishtinës

Më 26-27 Shtator 2022, në mbështetje të Depramentit të SHBA-ve në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Hetimi financiar”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimin sa më suksesshëm, grumbullim e provave dhe çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë me rastin e hetimit dhe gjyqimit të pastrimit të parave dhe veprave penale që ndërlidhen me të.

Në ditën e parë trajnimi u fokusua në shpjegime të hollësishme sa i përket teknikave të hetimit, bashkëpunimit në mes të policisë dhe prokurorisë/hetuesit si dëshmitarë, hetimit financiar në rastet e mashtrimit të prokurimit si dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë/dëshmitarët bashkëpunues

Gjatë trajnimit u potencua se Policia për shumë kategori veprash penale, si vjedhjet, plagosjet etj. mund të hetojë për aq sa është e mundur dhe ta dërgojë çështjen në prokurori vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet hetimore që ka në dispozicion. Kurse për veprat në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit është e preferueshme që çështjet t’u vihen në dijeni prokurorëve sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që këto çështje të hetohen bashkërisht,

si një përpjekje e përbashkët midis policisë dhe prokurorëve.

Me tutje është potencuar se asnjë çështje nuk mund të hetohet apo të ndiqet penalisht me sukses pa bashkëpunimin dhe dëshminë e dëshmitarëve të besueshëm. Për këtë arsye u tha se është thelbësore që hetuesi të dijë të trajtojë dhe menaxhojë dëshmitarin në mënyrën e përshtatshme dhe profesionale. Gjatë trajnimit u tha se Dëshmitar është personi që ka njohuri të vërteta mbi fakte apo ngjarje të caktuara që kanë lidhje me hetimin apo me ndjekjen penale. Dëshmitari mund të jetë njëkohësisht edhe viktima e krimit, që do të thotë se ai është dëmtuar si pasojë e veprimeve kriminale të dikujt tjetër dhe mund të jetë gjithashtu “bashkëpunëtor në krim” ose “bashkëpunëtor me drejtësinë”, që do të thotë se ka informacion për një krim për shkak të pjesëmarrjes në kryerjen e tij.

Në ditën e dytë u trajtuan aspekte të rëndësishme të hetimit të transaksioneve ndërkombëtare/ Kompanitë fantome, pastrimi i parave - ndjekja e parave, elaborimi i provave financiare në aktakuzë, përdorimi i provave financiare në gjykatë, konfiskimi i aseteve dhe kthimi i tyre.

Për dy ditë me radhë pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit interaktiv por edhe studimit të rasteve nga praktika e Prokurorisë Federale në Distriktin verior të Ohajos.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 12 prokuror nga Prokuroria Themelore ne Prishtine, 4 zyrtar nga Policia e Kosovës, 2 nga Njësia e Inteligjencës Financiare dhe 3 Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Trajnim: Veprat penale kundër jetës dhe trupit me fokus te vepra penale e vrasjes dhe vrasjeve të rënda

Më 27 Shtator 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Veprat penale kundër jetës dhe trupit me fokus te vepra penale e vrasjes dhe vrasjeve të rënda”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me veprat penale kundër jetës së trupit dhe vrasjeve të rënda në mënyrë që të kuptojnë dhe interpretojnë dispozitat ashtu siq duhet dhe të marrin vendime meritore.

Trajnimi në fillim është fokusuar në shpjegimet e hollësishme të veprës penale kundër jetës, vrasjet dhe llojet e vrasjeve si dhe për vrasjet e kualifikuara dhe të privileguara.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar të drejtave themelore dhe absolute të njeriut duke vënë në pah se veprat penale kundër jetës dhe trupit janë një ndër inkriminimet më të rëndësishme si në ligjet e kohës së vjetër, ashtu edhe në ligjet e periudhave të mëvonshme dhe deri në ditët e sotme.

Në veçanti u trajtuan çështjet që kanë të bëjnë me te drejtat e njeriut dhe jetës me përkufizimin e parimit se drejta e jetës është e

garantuar me ligj dhe me dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, siç janë: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (neni 2); Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 3); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 6); Konventa e të Drejtave të Fëmijës (neni 6), etj.

Pjesëmarrësit patën rastin e studimit të një rasti praktik të vrasjes për të cilin kishin për të identifikuar mënyrën e kryerjes, motivin dhe rrethanat tjera dhe në këtë mënyrë edhe diskutimin e përbashkët edhe cilësimin e veprës.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në teori dhe diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore, si dhe punë në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 12 gjyqtarë kryesisht nga niveli themelor si dhe 7 prokurorë, 1 nga PRSK dhe 6 të tjerë nga Prokuroritë Themelore nga të gjitha regjionet.



Trajnim: Sistemi Evropian i informacionit për evidencën penale

Më 28 Shtator 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Sistemi Evropian i Informacionit për Evidencën Penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me Sistemin Evropian të Informacioneve për Evidencën Penale, (ECRIS), i cili mundëson ndarjen e të dhënave kriminale evropiane, midis shteteve anëtare të BE-së.

Trajnimi në fillim u fokusua në shpjegimet sa i përket përkufizimit, rolit të ECRIS si autoritet qendror në vendet anëtare, gjuhët e ECRIS dhe në vijim për karakteristikat kryesore dhe Kornizën ligjore e saj, ndarjen e përgjegjësive të ECRIS midis KE dhe MS-neni 3 vendimi i Këshillit 2009/316/JHA, elementet e ECRIS si dhe fusha e vendimit kornizë të Këshillit 2009/315/JHA.

Në pjesë e pasdites u trajtuan aspekte të rëndësishme të drejtave themelore dhe mbrojtjes së të dhënave që i ka në konsideratë ECRIS si dhe për detyrimet e shteteve anëtare

dënuese, shteteve anëtare të kombësisë së personit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe detyrimit për përgjigje ndaj një kërkesë për informacion mbi dënimet, afateve për përgjigje, transmetimit të informacionit, llojeve të tyre kur janë të detyrueshme, kur janë osionale dhe për informacionin shtesë.

Me rastin e këtij trajnimi u potencua që sistemi ECRIS mundëson shkëmbimin efikas midis shteteve anëtare për dënimet e mëparshme penale nga gjykatat penale të BE-së. Gjithashtu pjesëmarrësit patën rastin që përmes rastit praktik të diskutojnë për rolin dhe përparësitë e kësaj sistemi në sigurinë e qytetarëve brenda zonës së BE-së.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 2 gjyqtarë nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe 1 prokuror nga Prokuroria Themelore në Ferizaj.



Trajnim: Hetimi financiar/ Trajnim per Prokuroret e Prokurorise Speciale

Më 28-29 Shtator 2022, në mbështetje të Departamentit të SHBA-ve në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Hetimi financiar”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimin sa më suksesshëm, grumbullim e provave dhe çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë me rastin e hetimit dhe gjykimin të pastrimit të parave dhe veprave penale që ndërliken me të.

Në ditën e parë trajnimi u fokusua në shpjegime të hollësishme sa i përket teknikave të hetimit, bashkëpunimit në mes të policisë dhe prokurorisë/hetuesit si dëshmitarë, hetimit financiar në rastet e mashtrimit të prokurimit si dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë/dëshmitarët bashkëpunues

Gjatë trajnimit u potencua se Policia për shumë kategori veprash penale, si vjedhjet, plagosjet etj. mund të hetojë për aq sa është e mundur dhe ta dërgojë çështjen në prokurori vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet hetimore që ka në dispozicion. Kurse për veprat në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit është e preferueshme që çështjet t’u vihen në dijeni prokurorëve sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që këto çështje të hetohen bashkërisht,

si një përpjekje e përbashkët midis policisë dhe prokurorëve.

Me tutje është potencuar se asnjë çështje nuk mund të hetohet apo të ndiqet penalisht me sukses pa bashkëpunimin dhe dëshminë e dëshmitarëve të besueshëm. Për këtë arsye u tha se është thelbësore që hetuesi të dijë të trajtojë dhe menaxhojë dëshmitarin në mënyrën e përshtatshme dhe profesionale. Gjatë trajnimit u tha se Dëshmitar është personi që ka njohuri të vërteta mbi fakte apo ngjarje të caktuara që kanë lidhje me hetimin apo me ndjekjen penale. Dëshmitari mund të jetë njëkohësisht edhe viktima e krimit, që do të thotë se ai është dëmtuar si pasojë e veprimeve kriminale të dikujt tjetër dhe mund të jetë gjithashtu “bashkëpunëtor në krim” ose “bashkëpunëtor me drejtësinë”, që do të thotë se ka informacion për një krim për shkak të pjesëmarrjes në kryerjen e tij.

Në ditën e dytë u trajtuan aspekte të rëndësishme të hetimit të transaksioneve ndërkombëtare/ Kompanitë fantome, pastrimi i parave - ndjekja e parave, elaborimi i provave financiare në aktakuzë, përdorimi i provave financiare në gjykatë, konfiskimi i aseteve dhe kthimi i tyre.

Për dy ditë me radhë pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit interaktiv por edhe studimit të rasteve nga praktika e Prokurorisë Federale në Distriktin verior të Ohajos.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 12 prokuror nga PSRK, 1 nga Prokuroria Themelore Prishtinë, 5 zyrtar nga Policia e Kosovës, 2 nga Njësia e Inteligjencës Financiare dhe 2 nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Aktivitetet për trajnues

Trajnim i avancuar i Trajnuesve për Ndërmjetësim

Nga data 27 shtator e deri më 29 shtator, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtitimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së, ka zhvilluar sesionin e tretë të Trajnimit të Trajnuesve për Ndërmjetësim.

Trajnimi u zhvillua edhe si vazhdimësi e Javës së Ndërmjetësimit, e cila ka filluar nga data 20 shtator, e që Akademia e Drejtësisë ka qenë një nga Institucionet kyçe në fushatën e proklamimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve rreth procedurës së Ndërmjetësimit.

Me anë të sesioneve të vazhdueshme të Trajnimit, Akademia e Drejtësisë, synon që të krijohet një kuadër i profesionalizuar i trajnuesve nga fusha e Ndërmjetësimit, të cilët do vazhdojnë pastaj trajnimet në AD, varësisht nevojave dhe programit trajnues për Gjyqtarët,



Prokurorët, stafin administrativ të Gjykatave dhe Prokurorive, si dhe profesionet e lira.

Gjatë sesionit të III-të trajnimit, ekspertët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës z. Dave Moora dhe znj. Emily Rife u fokusuan më shumë në trajtimin e zhvillimit të shkathtësive trajnuese në sallë, për parimet e mësimin të të rriturve, ushtrimet hapëse për aktivizimin e pjesëmarrësve në trajnim, lojërat në role etj. Gjithashtu fokusi ishte edhe tek fjala hyrëse në ndërmjetësim, mënyra e përdorimit të teknologjisë në mënyrë sa më efektive, format e tejkalimit të mosmarrëveshjeve.



Të gjitha temat e diskutimit, u pasuan edhe me ushtrime praktike, dhe role simuluese nga pjesëmarrësit, të monitoruara nga trajnuesit. Përfitues të Trajnimit ishin 15 ndërmjetësuesit e përzgjedhur për Programin Trajnues të Ndërmjetësimit.





Vijueshmëria në trajnim në PTF përmes grafikoneve






Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660